



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government

Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo zdravstva - Ministry of Health
Divizioni i Prokurimit/Divizia Nabavke/Procurement Division

Prishtine datë, 30.01.2024

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit Ministrise se Shendetsise, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit per Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 dhe Rregulloren për Prokurimin publik të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **kërkesës për ri-shqyrtim** të datës 24.01.2024 të parashtruar nga OE Enggroup Shpk me kodin e ofertes **1124**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Hartimi i projektit ideor dhe kryesor për Kompleksin Qendra e ISSH dhe QIRSKP ne Shtime”**, me Nr. të Prok: **206-23-10983-4-1-3** nxjerr:

V E N D I M

1. **Refuzohet**, si e jashtë afatshme kërkesa për ri-shqyrtim e OE ankues Enggroup Shpk me kodin e ofertes **1124**, e datës: 24.01.2024 ora **20:47**, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **“Hartimi i projektit ideor dhe kryesor për Kompleksin Qendra e ISSH dhe QIRSKP ne Shtime”** me nr. të prokurimi: **206-23-10983-4-1-3**, pasi që e njëjta është parashtruar jashtë afatit ligjor për rishqyrtim në Autoritetin Kontraktues.
2. **Vërtetohet**, NJOFTIMI PËR REZULTATET E KONKURSIT TË PROJEKTIMIT i datës 19.01.2024;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që te vazhdoj me aktivitetin e prokurimit;
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net> .

A R S Y E T I M

Operatori Ekonomik Enggroup Shpk me kodin e ofertes **1124** me date 24.01.2024 ora **20:47**, ka parashtruar kërkesë për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Hartimi i projektit ideor dhe kryesor për Kompleksin Qendra e ISSH dhe QIRSKP ne Shtime”** me nr. prokurimi 206-23-10983-4-1-3. Autoriteti Kontraktues, me datë 30.01.2024, ka shqyrtuar dhe refuzuar kërkesën në fjalë me arsyetimin si më poshtë:

Afati i fundit për dorëzim te kërkesës për rishqyrtim ka qene deri me date 24.01.2024 në ora 16:00, ndërsa Operatori Ekonomik: Enggroup Shpk ka bërë kërkesë për ri-shqyrtim me date 24.01.2024 në ora 20:47 (4:47 ore jashte afatit kohore per parashtrim te kerkeses per rishqyrtim).

Baza Ligjore për refuzim të Kërkesës për Ri-shqyrtim

Ligji i Prokurimit Publik në bazë të nenit 108/A – Zgjidhja e mosmarrëveshjeve, para 3. i cili thekson:

“3. Kërkesa për shqyrtim duhet të dorëzohet tek autoriteti përkatës kontraktues, me postë ose me çdo mjet tjetër të komunikimit të lejuar me këtë ligj, brenda afateve të mëposhtme:

1.2 në qoftë se shkelja e supozuar ka të bëjë me vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit, brenda afatit prej pesë (5) ditëve pas datës së njoftimit për dhënien e kontratës ose njoftimit mbi rezultatet e konkursit të projektimit që i është dërguar ankuesit.

Operatori Ekonomik ankimor ka dorëzuar Kërkesen për rishqyrtim me datë 24.01.2024 në ora 20:47.

Duke u bazuar në dispozitat e nenit 108/a par.3 dhe 3.2. OE ankimor ka lëshuar afatin ligjor (ius strictum) për të parashtruar ankesë pasi që ka parashtruar ankesë pas afatit të fundit për ofertave.

Nenin 60.1(b) i Rregullave të prokurimit publik

Kurdo që kërkesa për rishqyrtim ka të bëjë me vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit brenda afatit prej pesë (5) ditëve pas datës së publikimit të njoftimit mbi vendimin e AK (B58) ose njoftimit mbi rezultatet e konkursit të projektimit në sistem të prokurimit elektronik. Në kalkulim të afateve kohore, dita e publikimit të Njoftimit mbi vendimin të AK (B58) është dita (0)

Nenin 63.2 i Rregullave të prokurimit publik

Vendimi mbi refuzimin ose miratimin është obligativ dhe do të publikohet në sistem të prokurimit elektronik nga Zyrtari Përgjegjës i prokurimit. Në rastet kur zyrtari përgjegjës i prokurimit nuk nxjerrë vendim në lidhje me kërkesën për shqyrtim dhe nuk njofton operatorin ekonomik për afat shtesë, Operatori Ekonomik ka të drejtë që të parashtror një ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit pas skadimit të afatit prej 3 (tre) dite pune nga data e dorëzimit të kërkesës për rishqyrtim. Në kalkulim të afateve kohore data e dorëzimit të kërkesës për rishqyrtim është dita (0).


AK hedh poshtë ankesën e parashtruar në perrputhje me nenin 108/a i LPP-se paragrafi 8.1 cili nen përcakton se:

Autoriteti kontraktues do ta refuzojë një kërkesë për rishqyrtim kur: 8.1 kërkesa nuk dorëzohet brenda afateve kohore të përcaktuara në paragrafin 3 të këtij neni.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thane më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit të këtij vendimi.



Berat Marmullaku

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit